

## RAPORTI I SHPERNDARJES SE AGJENCISE ALBAUTOR PER VITIN 2021

Gjendja e të drejtës së autorit në Republikën e Shqipërisë është ende në nivelet e viteve 90'. Ajo paguhet vetëm në masën 0.3% dhe pjesa tjetër 99.7% vazhdon të vidhet sot e kësaj dite para syve të çdo autoriteti të ngarkuar për vjeljen dhe respektimin e kësaj të drejte. Ndërkohë Agjencia Albautor si çdo vit kryen funksionin e saj dhe me 0.3% të të ardhura arrin të mbijetojë dhe të shpërndajë tek autorët mbajtës të të drejtave pjesën më të madhe të të ardhurave, mbi 70%, si më poshtë gjendet e detajuar.

### ➤ Të ardhurat e Agjencisë Albautor për vitin 2021

Viti 2021 pati një rritje të të ardhurave krahasuar me vitin 2020. Ato ishin **24,446,491 lekë** ndërsa një vit më parë ishin 9.347.993 lekë. Kjo rritje erdhi kryesisht prej rillogaritjes të shpërndarjeve të kryer nga Qendra SUADA që prej vitit 2018 deri në vitin 2021, e cila rezultoi në fund me një vlerë shtesë prej 15.380.549 lekë që u shpërndanë vetëm për tre agjencitë e licensuara (pra duke hequr agjencinë e producentëve), si dhe prej faktit se fondet e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë të cilat nuk paguheshin që prej dy vitesh në vlerë 12.306.000 lekë, u shpërndanë kësaj radhe nëpërmjet SUADA-s duke sjellë për Agjencinë Albautor një vlerë në përqindje më të lartë sesa kur merreshin drejtpërdrejtë.

Përfunduar këto rrethana të papërsëritshme subjektet tregtare që paguajnë të drejtën e autorit ende vazhdojnë të mbeten shumë pak, vetëm 131 subjekte gjithsej, pa ndonjë rritje për t'u përmendur krahasuar me vitin 2020 kur rezultuan 111 subjekte pagues, ndërkohë që në vitin 2019, vitin më të mirë deri më sot të Qendrës SUADA, ishin 503 subjektet që paguan të drejtën e autorit. Ende nuk e paguajnë të drejtën e autorit të gjitha grupet mediatike, qendrat e mëdha tregtare si dhe vetë institucionet shtetërore që sponsorizojnë koncerte në vlera prej miliona eurosh.

**Këto vlera gjenden të pasqyruara në Bilancin zyrtar si më poshtë:**

gned\_BILANClifimosur.pdf <https://cats.tatime.gov.al/cats/TaxpayerBalanceSheets/View/Downloa...>

**Njësia Jo Fitimprurëse "ALBAUTOR"**  
**Pasqyra e Aktiviteteve (performancës)**  
31 dhjetor 2021  
(Shpenzimet të paraqitura sipas funksionit)

Përshkrimi i zërit	2021	2020
Ndryshimi në aktivet neto të pakufizuara:		
<b>Të ardhurat:</b>		<b>9,347,993</b>
Të ardhura nga tarifat e anëtarësimit		
Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare		
Të ardhura Sporteli Unik SUADA	19,349,020	2,673,358
Të ardhura nga agjencitë e huaja të të drejtave të autorit	5,090,290	
Tarifat për shërbimet		6,674,635
Të ardhura nga aktivitetet tregtare		
Të ardhura të tjera		
Fitime nga kursi i këmbimit	7,181	
<b>Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara</b>	<b>24,446,491</b>	<b>9,347,993</b>

Të ardhurat e detajuara dhe të grupuara sipas kategorive të biznesit që kanë paguar të drejtën e autorit për vitin 2021, si dhe të ardhurat nga agjencitë e huaja simotra për të drejtat e autorit me të cilat Albautor ka lidhur marrëveshje reciproke përfaqësimi, janë si më poshtë:

TABELA 1

## TË ARDHURAT E AGJENCISË ALBAUTOR 2021

### 24,446,491 lekë

Të ardhura nga Qendra SUADA		Të ardhura nga shoqatat partnere	
19,349,020 Lekë		5,090,290 Lekë	
Televizione Kabllor	59.26%	SUISA (Zvicër)	2,636,977.44 Lekë
Q.K.K.	10.83%	GEMA (Gjermani)	1,630,691.56 Lekë
Radio	9.97%	MDS (Zvicër)	430,111.85 Lekë
Njësi Tregtare	6.94%	TEOSTO (Finlandë)	210,223.36 Lekë
Televizione	6.41%	SAIF (Francë)	47,607.79 Lekë
Hoteleri	5.16%	PRS (Angli)	45,716.11 Lekë
Evente/Koncerte	0.84%	BUMA (Holandë)	39,722.85 Lekë
Bar-Kafe	0.58%	OSA (Çeki)	19,678.63 Lekë
Arkivi i Filmit	0.01%	ARTISJUS (Hungari)	13,256.03 Lekë
		ZAIKS (Poloni)	8,855.89 Lekë
		EAU (Estoni)	7,448.34 Lekë

### ➤ Shpenzimet e Agjencisë Albautor për vitin 2021

Për vitin 2021 shpenzimet total të Agjencisë Albautor ishin **7,320,568 lekë** duke u stabilizuar në nivelin e shpenzimeve të vitit 2020 të cilat ishin 7.150.188 lekë, por në ndryshim me vitet e mëparshme viti 2021 pati disa shpenzime shtesë për shkak të rilicensimit të Agjencisë nga ana e Ministrisë së Kulturës që vetëm për regjistrimin parashikon një tarifë prej 300.000 lekësh pa përfshirë këtu kosto të tjera për përkthimin dhe noterizimin e dokumentacionit të kërkuar.

Nëse do të zbrisnim kostot e rilicensimit që nuk janë pjesë e administrimit të zakonshëm vjetor, rezulton se shpenzimet për vitin 2021 janë edhe më të ulëta se ato të vitit 2020 që përbëjnë deri më sot nivelin më të ulët të shpenzimeve të regjistruar nga Albautor. Kjo ndodh sepse për të dytin vit rresht janë kryer vetëm shpenzimet bazë ku vetëm zërat si paga, taksa dhe qiraja e zyrave përbëjnë 84% të shpenzimeve totale, dhe nuk është kryer asnjë investim që do të mund të sillte në të ardhmen një rritje të kapaciteteve mbledhës dhe përpunues të të drejtave të autorit.

**ALBAUTOR**

Blvd. "Bajram Curri", 114, Tiranë

Shpenzimet e pasqyruara në Bilancin zyrtar:

<b>Shpenzime për aktivitetet</b>		
Materiale të konsumuara	(208,109)	(99,095)
Pagat e personelit	(4,445,528)	(4,022,694)
Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	(632,586)	(538,571)
Shpenzime amortizimi	(26,004)	-
Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme	(2,008,341)	(2,489,828)
Krijim dhe rritje fondesh		
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>(7,320,568)</b>	<b>(7,150,188)</b>

Shpenzimet e detajuara sipas zërave:

TABELA 2

**SHPENZIMET E AGJENCISË ALBAUTOR 2021**  
**7,320,568 lekë**

Lloji i Shpenzimit	Vlera
Pagat e personelit	4,445,528 Lekë
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	632,586 Lekë
Qera zyre	606,200 Lekë
Shpenzime noterie, çertifikata dhe liçenca	340,500 Lekë
Auditime dhe asistencë ligjore	430,535 Lekë
Honorare për pjesëmarrje në Këshillin Drejtues	120,000 Lekë
Pastrim ambjentesh dhe materiale higjene	115,665 Lekë
Shpenzime postare, telefon, internet	90,056 Lekë
Shërbime bankare (Komisione)	81,490 Lekë
Shpenzime të ndryshme zyre	179,145 Lekë
Shpenzime energji elektrike dhe Ukt	160,081 Lekë
Blerje /Shpenzime të tjera (Kancelari)	48,028 Lekë
Amortizime	26,004 Lekë
Shpenzime transporti	29,750 Lekë
Tatime të tjera (Taksa Bashkiake)	15,000 Lekë
<b>TOTALI</b>	<b>7,320,568 Lekë</b>

➤ **Shpërndarja e Agjencisë Albautor për vitin 2021**

Agjencia Albautor si një organizatë jofitimprurëse duhet të shpërndajë tek autorët mbajtës të të drejtave të autorit, të ardhurat që mbeten pas zbritjes së shpenzimeve administrative, dhe për vitin 2021 shpërndarja rezulton të jetë në vlerën **17,125,923 lekë**, pra diferenca e të ardhurave (24,446,491 lekë) dhe shpenzimeve (7,320,568 lekë).

Vlera 17,125,923 lekë do të shpërndahet tek autorët bazuar në raportet e përdorimit që janë depozituar pranë Agjencisë Albautor, si dhe nga aplikimi i metodave statistikore të zgjedhura nga Agjencia bazuar në pikën 2 të nenit 150 të Ligjit Nr. 35/2016, për të gjitha rastet e tjera kur të ardhurat janë depozituar pa të dhëna përdorimi ose kur përpunimi i tyre rezulton dukshëm joekonomik për shpërndarjen.

**1. Konkretisht, do të shpërndahet bazuar në Sistemin e Pikëzimit të miratuar për vitin 2021 vlera 12,940,554 lekë për të cilën nuk ka të dhëna përdorimi:**

**SISTEMI I PIKËZIMIT PËR SHPËRNDARJEN E TË ARDHURAVE 2021**

- 1) Çdo vepër e deklaruar merr 1 pikë si njësi.
- 2) Këngët e prezantuara në vitet 1990 - 2000 marrin 3 pikë shtesë. Këngët e viteve 2000 - 2016 marrin 6 pikë shtesë.
- 3) Kënga si përfaqësim në festivale RTSH (Fest. Fëmijësh Shkoder, Tiranë, Koncert Pranvere, Anketa dhe Festivali i Këngës), Top Fest dhe Kënga Magjike, merr edhe 10 pikë shtesë.
- 4) Kënga me çmime në festivalet e mësipërme merr edhe 20 pikë shtesë.
- 5) Kënga përfaqësuese në Eurosong merr edhe 60 pikë shtesë.
- 6) Kënga në Youtube merr nga një pikë shtesë për çdo 50 mijë klikime.
- 7) Muzika Klasike ndahet në pikë si më poshtë:

- |                                 |                               |
|---------------------------------|-------------------------------|
| a) Simfonia 100 Pikë            | l) Valle simfonike 40 pikë;   |
| b) Opera 100 Pikë;              | m) Rapsodi 40 pikë;           |
| c) Balet 100 Pikë;              | n) Numër koreografik 20 pikë; |
| d) Operetë 90 pikë;             | o) Skicë 20 pikë;             |
| e) Koncert 80 pikë;             | p) Romancë 20 pikë;           |
| f) Suitë 70 pikë;               | q) Variacion 20 pikë;         |
| g) Musical 60 pikë;             | r) Piano solo 20 pikë;        |
| h) Muzikë dhome 50 pikë;        | s) Kantate 20 pikë;           |
| i) Duo, trio, quartet 50 pikë;  | t) Rondo 20 pikë;             |
| j) Korale 40 pikë;              | u) Overturë 20 pikë;          |
| k) Vocale zë dhe piano 40 pikë; | v) Vepra teatrale 20 pikë;    |

Bazuar në Sistemin e mësipërm të pikëzimit çdo autor që ka depozituar listën e krijimtarisë së tij pranë Agjencisë Albautor deri në datën 31 Dhjetor 2021, do të paguhet bazuar në pikët e grumbulluara dhe vlerës në lekë që ka një pikë për vitin 2021, e cila llogaritet duke pjesëtuar vlerën totale të lekëve për t'u shpërndarë me sasinë totale të pikëve të grumbulluara nga të gjithë autorët. Në vitin 2021 vlera e pikës që do të përdoret për llogaritjen rezultoi 85,63028 lekë (12,940,554 lekë / 151,121.24 pikë).

TABELA 3

### AUTORËT PËR T'U PAGUAR NGA SISTEMI I PIKËZIMIT PËR VITIN 2021

Nr.	Emri i Autorit	Nr. i Veprave muzikore të deklakuara 2021	Pikët e grumbulluara sipas sistemit të pikëzimit	Pagesa totale që rezulton për vitin 2021	Pagesa neto pas mbajtjes së Tatimit 15% mbi të ardhurat personale
TOTAL		15,297.00	151,121.24	12,940,554.52	10,999,471.34

2. Për muzikën e përfaqësuar nga agjencitë e huaja të të drejtave të autorit të transmetuar në territorin shqiptar është përcaktuar të shpërndahet vlera 2.000.000 lekë, vlerë të cilës do t'i shtohet edhe shuma që ka rezultuar nga raportimet e eventeve të mbledhura nga Qendra Suada dhe që për këto evente/koncerte kanë raportuar veprat e përdorura. Si rezultat për agjencitë e huaja simotra për vitin 2021 rezulton që do të shpërndahet shuma totale 2,045,306 lekë e pasqyruar si më poshtë: (Sqarim: për vlerën 2.000.000 lekë për të cilën nuk ka raporte përdorimi për t'i shpërndarë tek agjencitë e huaja jemi në bisedime me CISAC për metodologjinë e shpërndarjes. Një mundësi është që të shpërndahen proporcionalisht mes agjencive më poshtë që kanë rezultuar përfituese nga raportimet e eventeve të zhvilluara gjatë vitit 2021.)

TABELA 4

### PAGESAT PËR AGJENCITË E HUAJA TË TË DREJTAVE TË AUTORIT

AGJENCITË E HUAJA TË ADMINISTRIMIT TË TË DREJTAVE TË AUTORIT	AGJENCITË E HUAJA TË ARDHURA NGA EVENTET SUADA	AGJENCITË E HUAJA TË ARDHURA NGA QKK	AUTORË SHQIPTARË TË REGJ. NË AGJENCITË E HUAJA EVENTET SUADA	TOTALI
APRA	1,556.90			1,556.90
ASCAP	2,750.86			2,750.86

**ALBAUTOR**

Blvd. "Bajram Curri", 114, Tiranë

BMI	3,352.88		1,495.24	4,848.12
IMRO			7,824.62	7,824.62
JASRAC	343.88			343.88
KODA	343.88			343.88
MESAM	103.16			103.16
MSG	240.72			240.72
PRS	2,774.90			2,774.90
SACEM	1,260.62			1,260.62
SGAE	85.97			85.97
SIAE	257.91		275.82	533.73
SOCAN	966.47			966.47
SOKOJ			551.64	551.64
SPA	1,767.94			1,767.94
SUISA	261.89	16,630.85		16,892.74
ZAMP			367.07	367.07
PA IDENTIFIKUAR	2,092.86			2,092.86
PA PERCAKTUAR				2,000,000.00
<b>TOTAL</b>				<b>2,045,306.09</b>

3. Shpërndarja e të ardhurave të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë do të bëhet bazuar në raportimet e QKK-së për transmetimin e filmave dhe dokumentarëve. Konkretisht Albautor nga pagesa e QKK ka përfituar vlerën 1,582,200 lekë për vitin 2021. Kësaj shume iu mbajt kostoja e administrimit të vitit 2021 prej 29.95% dhe vlera 70.05% (1,108,331.95 lekë) do t'i shpërndahet autorëve si më poshtë:

TABELA 5

### SHPËRNDARJA E QENDRËS KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË 2021

NR.	AUTORËT	DIGIT-ALB	TRING FILMA	TRING DOK.	TOTAL	TOTAL (Neto)
<b>TOTAL</b>		<b>439,386.73</b>	<b>426,285.90</b>	<b>76,409.52</b>	<b>1,108,331.95</b>	<b>942,082.15</b>

Për anëtarët e Agjencisë Albautor vlera e mësipërme që rezulton nga pagesa e QKK-së do t'i bashkohet pagesave të tjera që kanë rezultuar për ta dhe në fund do të bëhet një transfertë e vetme bankare që i përfshin të gjitha të ardhurat. Ndërsa për autorët më sipër që nuk janë anëtarë të Agjencisë Albautor do të kontaktohen dhe do të bëhen përpjekje gjatë vitit për t'i anëtarësuar në Albautor, dhe nëse nuk do të arrihet dot anëtarësimi i tyre, vlerat që kanë



**ALBAUTOR**

Blvd. "Bajram Curri", 114, Tiranë

rezultuar për ta si më sipër do të depozitohen pas datës 31 Dhjetor në llogarinë e Ministrisë së Kulturës ku do të qëndrojnë të ngrira për tre vitet në vijim në pritje deri sa autorët të anëtarësohen në Albautor. *(Këta autorë si dhe pagesat që do të depozitohen në llogarinë e Ministrisë pas datës 31 Dhjetor paraqiten si më poshtë)*

TABELA 5b

**SHPËRNDARJA E QKK TEK JO ANËTARËT**

NR.	AGJENCIA	AUTORËT	DIGITALB	TRING FILMA	TRING DOK.	TOTAL	TOTAL (neto)
TOTAL			90,099	87,501	72,624	294,381	250,224

4. Të ardhurat nga jashtë me raporte monitorimi janë në vlerën **297,118.51 lekë** të cilat do të shpërndahen sipas tabelës më poshtë:

TABELA 6

**SHPËRNDARJA NGA JASHTË 2021**

NR.	AUTORËT	DËRGUAR	KOSTO ADM	PAGUAR	VLERA NETO
TOTAL		424,152.04	127,033.54	297,118.51	252,550.73

Për anëtarët e Agjencisë Albautor vlerat e mësipërme do t'i bashkohen pagesave të tjera që kanë rezultuar për ta dhe në fund do të bëhet një transfertë e vetme bankare që i përfshin të gjitha të ardhurat. Ndërsa për autorët të cilët nuk janë anëtarë të Agjencisë Albautor do të bëhen përpjekje gjatë vitit për t'i anëtarësuar dhe nëse kjo nuk do të arrihet dot, vlerat e raportuara për ta do të depozitohen pas datës 31 Dhjetor në llogarinë e Ministrisë së Kulturës ku do të qëndrojnë të ngrira për tre vitet në vijim në pritje që këta autorë të anëtarësohen në Albautor. *(Autorët dhe pagesat që do të depozitohen në llogarinë e Ministrisë së Kulturës pas datës 31 Dhjetor paraqiten si më poshtë)*

TABELA 6b

**SHPËRNDARJA NGA JASHTË 2021 (TE JO ANËTARËT)**

NR.	AUTORET	DERGUAR	KOSTO ADM	PAGUAR	VLERA NETO
TOTAL		100,708.46	30,162.18	70,546.28	59,964.34

5. Të ardhurat nga eventet dhe koncertet të cilat kanë dorëzuar lista përdorimi pranë Qendrës SUADA dhe që rrjedhimisht do të shpërndahen bazuar në këto lista janë në vlerën 59,917.97 lekë dhe paraqiten si më poshtë:

TABELA 7

### AUTORË SHQIPTARË QË REZULTOJNË NGA EVENTET SUADA 2021

NR.	AUTORI	Vlera Bruto	Vlera Neto pas mbajtjes së Tatimit në Burim 15%
<b>TOTAL</b>		<b>41,757.12</b>	<b>35,493.55</b>

Për anëtarët e Agjencisë Albautor vlerat e mësipërme do t'i bashkohen pagesave të tjera që kanë rezultuar për ta dhe në fund do të bëhet një transfertë e vetme bankare që i përfshin të gjitha të ardhurat. Ndërsa për autorët të cilët nuk janë anëtarë të Agjencisë Albautor do të bëhen përpjekje gjatë vitit për t'i anëtarësuar, dhe nëse kjo nuk do të arrihet dot vlerat e raportuara për ta do të depozitohen pas datës 31 Dhjetor në llogarinë e Ministrisë së Kulturës ku do të qëndrojnë të ngrira për tre vitet në vijim në pritje që këta autorë të anëtarësohen në Agjencinë Albautor. (Autorët dhe pagesat që do të depozitohen në llogarinë e Ministrisë së Kulturës pas datës 31 Dhjetor paraqiten si më poshtë)

TABELA 7b

### AUTORË SHQIPTARË JO ANËTARË QË REZULTOJNË NGA EVENTET SUADA 2021

NR.	AGJENCI	AUTORI	Vlera Bruto	Vlera Neto pas mbajtjes së Tatimit në Burim 15%
<b>TOTAL</b>			<b>19,215.55</b>	<b>16,333.22</b>

Nga raportimet e eventeve dhe koncerteve të mbledhura kanë rezultuar edhe pagesa për krijime muzikore të përfaqësuar nga Agjencitë e huaja të të drejtave të autorit si më poshtë:

TABELA 7c

### AUTORË DHE PUBLISHER TË HUAJ QË REZULTOJNË NGA EVENTET SUADA 2021

TITULLI	AUTORI (TË HUAJ)	SHOQËRIA	Vlera Bruto	Vlera Neto pas mbajtjes së Tatimit në Burim 15%
---------	------------------	----------	-------------	---



***ALBAUTOR***

Blvd. "Bajram Curri", 114, Tiranë

<b>TOTAL</b>	<b>18,160.85</b>	<b>15,436.72</b>
--------------	------------------	------------------

6. Anëtarëve të Asamblesë do t'u shtohet edhe shuma 720.000 lekë që do të shpërndahet në mënyrë të barabartë mes të gjithë anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të Agjencisë Albautor.

Në përfundim vlerat që do të shpërndahen për anëtarët e Agjencisë Albautor do të jenë sipas tabelës përfundimtare të paraqitur këtu më poshtë që përfshin të gjitha pagesat e grumbulluara për secilin anëtar nga të gjitha burimet e të ardhurave.

TABELA 8

### PAGESAT E ANËTARËVE TË AGJENCISË ALBAUTOR PËR VITIN 2021

Nr.	Emri i Autorit	Nr. i Veprave Muzikore 2021	Pikët e grumbulluara	Pagesa totale për vitin 2021	Pagesa neto pas mbajtjes së Tatimit 15% mbi të ardhurat personale
<b>TOTAL</b>		<b>15,297</b>	<b>151,121</b>	<b>14,723,620</b>	<b>12,515,077</b>

*Në përfundim pagesat totale që do të bëhen tek mbajtësit e të drejtave paraqiten në formë të përmbledhur në tabelën më poshtë:*

NR.	ZËRAT	VLERAT	TABELA
1	SHPËRNDARJE TEK ANËTARËT E AGJENCISË ALBAUTOR	14,723,619.57 LEKË	TABELA 8
2	SHPËRNDARJE TEK AGJENCITË E HUAJA TË TË DREJTAVE TË AUTORIT	2,045,306.09 LEKË	TABELA 4
3	SHPËRNDARJE TE JO ANËTARËT NGA TË DHËNAT E QKK-së	277,749.77 LEKË	TABELA 5b
4	SHPËRNDARJE TE JO ANËTARËT NGA JASHTË	70,546.28 LEKË	TABELA 6b
5	SHPËRNDARJE TE JO ANËTARËT NGA TË DHËNAT E QENDRËS SUADA	8,701.16 LEKË	TABELA 7b